



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:025192

Datë: 23.03.2023

Numri i dokumentit: 04114215

Ac.nr.9604/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi, kryetar i kolegjit, Lumni Sallauka dhe Hunaida Pasuli, anëtar të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditëses L. B. nga Gj., të cilin e përfaqëson me autorizim K.A.-S. avokate nga Gjilani, ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson, përfaqësuesi i saj ligjor Burim Maliqi nga Gjilani, me objekt kontesti, kompensimin e shpërblimit jubilar dhe kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.327/20 të datës 04.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.03.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit- Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.327/20, i datës 04.10.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë më Aktgjykimin e ankimuar C.nr.327/20 të datës 04.10.2021, ka aprovuar si të bazuar me ligj kërkesëpadinë e paditëses L. B. nga Gjilani dhe ka obliguar të paditurën që paditëses L. B. nga Gj. t’ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune në vlerë të 75 % të një page bazë, apo shumën prej 315.75 euro, si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 e deri më 11.03.2020, shumën e të hollave në lartësi prej 1,218.00 euro (për 609 ditë pune), respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,533.75 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë datë 19.02.2020, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.. Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka detyruar të paditurën Komuna e Gjilanit, që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës, edhe atë: për përpilimin e padisë nga avokati

shumën prej 104 euro; për pagesën e taksës taksës gjyqësore shumën prej 31 euro; për përfaqësimin e paditëses nga avokatja për një seancë gjyqësore shumën prej 135 euro, apo shumën e përgjithshme prej 270 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit më dhunë..

Kundër këtij Aktgjykimit, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë e paditura për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim si në të njëjtën.

Pala paditëse ka paraqitur përgjigje në padi, me anë të së cilës ka kundërshtuar ankesën e të paditurës Komuna e Gjilanit, me propozim si në të njëjtën.

Gjykata e Apelit pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e palës së paditur është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja në këtë Gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija e saj dhe të obligohet e paditura që paditëses, t'ia paguajë në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, si dhe kompensimin e shpërblimit në vlerë të 75 % të një page bazë në shumë prej 315.75 euro, me kamatë ligjore prej 8% ne vit, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm. Mirëpo me parashtrësën e datës 13.11.2021, të dorëzuar në gjykatë ka bërë precizimin dhe plotësimin e padisë dhe kërkesëpadiisë, ashtu që tani e tutje ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses në emër të shpërblimit jubilar, për 20 vite përvojë pune në vlerë të 75 % të një page bazë, apo shumën prej 315.75 euro, si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 e deri më 11.03.2020, shumën e të hollave në lartësi prej 1,218.00 euro (për 609 ditë pune), respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,533.75 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm, ndërsa pjesa tjetër e petitimit të kërkesëpadiisë mbetet e pandryshuar.

Duke vepruar sipas padisë së paditëses, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore, dhe ka administruar provat ku është vërtetuar se kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse mbeten faktet nëse kjo gjykatë ka kompetencë lëndore për të gjykuar rastin, pastaj nëse Kontrata Kolektive e lartëcekur prodhon efekt juridik për të paditurën meqenëse nuk është nënshkruar nga ana e saj, ditët e pranisë në punë të paditëses gjatë viteve shkollore 2017/-2018

dhe 2018-2019 dhe 2019-2010 si dhe nëse kemi parashkrim të kërkesave konform nenit 87 të Ligjit të Punës/ Ligji nr.03/L-212 i datës 01.Nëntor 2010/.

Gjykata e shkallës së parë, lidhur me pretendimet e të paditurës në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar thekson se është e kompetencës lëndore për të gjykuar rastin, pasi që sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Gjykatat e Rregullta/ Ligji nr. 06/L – 054 në nenin 12.1 decidivisht është përcaktuar se „Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe. Kurse Departamenti për Çështje Administrative në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas nenit 17 të Ligjit për Gjykatat gjykon çështjet administrative, respektivisht gjykon sipas padisë për hapjen e konfliktit administrativ, kur kemi një vendim administrativ të formës së prerë ndaj të cilit pala e pakënaqur ushtron padi me qëllim të realizimit të së drejtës së tij subjektive apo kur kemi të bëjmë me heshtje të administratës dhe për kategoritë e punëtorve që sipas nenit 4 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës/ Ligji Nr. 03/L-149/ marrëdhënia juridike e të cilëve rregullohet me këtë Ligj, të cilët sipas nenit 82 të Ligjit ndjekin procedurën e realizimit të së drejtës së tyre së pari në Komisionin për Ankesa dhe Parashtrës, pastaj i drejtohen Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës e pastaj me padi i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamentit për Çështje Administrative për hapjen e Konfliktit Administrativ, kurse siç dihet të punësuarve në sektorin e arsimit ju garantohet mbrojtje ligjore konform Ligjit të Punës së Kosovës.

Gjykata e shkallës së parë, ka shqyrtuar edhe pretendimin e të paditurës ku ka theksuar se paditësja fillimisht nuk i ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative para se të paraqes padi në gjykatë, mirëpo për gjykatën edhe ky pretendim i të paditurës është i pabazuar, pasi që, në bazë të shkresave të lëndës dhe provave të administruara, përkatësisht Formularit për kërkesë apo ankesë me nr. protokollit 05-610/01-0002878/20 të datës 10.01.2020 dhe Kërkesës për kompensimin, e po të njëjtës datë, rezulton se paditësja fillimisht iu ka drejtuar me kërkesë të paditurës për realizimin e të drejtës së tij, por e paditura nuk iu ka përgjigjur kërkesës së paditëses. Përveç kësaj, gjykata vlerëson se meqë e drejta e punës është kategori kushtetuese dhe e garantuar me konventa ndërkombëtare dhe me ligj, në rast të paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (kërkesat materiale), punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t'i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, e kjo duke u bazuar në nenit 87 të Ligjit të Punës, pasi që me dispozitën e këtij neni është paraparë qartë se: “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, andaj nga kjo dispozitë rezulton se paditësi brenda afatit të cekur më lartë mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore për kërkesat të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e punës në para, mirëpo kjo nuk nënkupton se paditësi nuk mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore pa i shtjerr mjetet juridike të e paditura ashtu siç pretendon e paditura, kjo ngase e paditura ka pas obligim ligjor që të përmbush detyrimin e saj ndaj paditësit në shumën e kërkuar dhe të aprovuar me kërkesëpadi në bazë të dispozitave të cekura më lartë.

Gjykata e shkallës së parë, poashtu konstatoi se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditëses edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit/Kontrata nr.24. e

datës 18.04.2017/, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunale apo DKA-të.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala e paditur me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike e as shkeljeve të tjera nga neni 181.1 dhe 182.2, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, par. 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura. Është vërtetuar përvoja e punës dhe prania në punë, përmes vërtetimeve të datës 17.12.2019 dhe 09.06.2020, bazuar në nenin 35 par.8 pika 8.1 dhe 8.2 të Kontratës Kolektive duke u bazuar në listën e përvojës së punës rezulton që paditësja, ka përvojë pune 20 vite në sistemin arsimor, ku 20 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit i takon shuma në vlerë të 75% të një page bazë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur se aktgjykimi është përfshirë në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar, në mënyrë të drejtë dhe duke bazuar në ligj e ka zbatuar të drejtën materiale.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditësit, duke e obliguar të paditurën që në emër të kompensimit të pagave jubilarë në shumën si në aktgjykimin e atakuar, me të drejtë është bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive në Kosovë, të lidhur dhe nënshkruar të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e parashtrimit të kërkesës për kompensimin e shpërblimit jubilar që rrjedhimisht nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadsisë. Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452.1 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të të paditurës, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.9604/2021, me datë 20.03.2023

Kryetar i kolegjit,
Ardian Ajvazi